



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1028 Prot.



PROJEKTVENDIM

Nr. 33, datë 15/04/2024

MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2024 PËR MBROJTJEN CIVILE, PËR REHABILITIMIN E PJESSHËM TË PËRROIT NË LAGJEN "E RE".

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 64 shkronja "c", nenit 54, shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", pika 3.1 shkronja "dh", "e", "f", "g", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" i ndryshuar, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë përdorimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për vitin 2024 për mbrojtjen civile, për rehabilitimin e pjesshëm të përroit, në lagjen "e Re" me vlerë 4,955,981.29 (katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë njëzetë e nëntë) lekë, sipas kodit të produktit **91707 AG** "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese".

Anëtarët e Programit të mbrojtjes nga zjarri, shpëtimit dhe mbrojtjes civile.

Ermenita Mjci

Gazmira Plesafi

Arben Shpërdheja

Alket Halimi

Vesjana Sanxhaku

Eljano Kumaraku

Juriste
Nurkë Hazizaj

Adresa: Lagja "Nafëtari", Rruga "Unaza", Patos



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 1028/1 Prot.

Patos, më 15/10/2024

RELACION

**MBI MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË
BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITIN 2024 PËR MBROJTJEN CIVILE, PËR
REHABILITIMIN E PJESSHËM TË PËRROIT NË LAGJEN “E RE”.**

Në mbështetje të nenit 64 shkronja “c”, nenit 54, shkronja “dh” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, pika 3.1 shkronja “dh”, “e”, “f”, “g”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” i ndryshuar, Ekipi i menaxhimit të mbrojtjes civile duke parë situatën në të cilën ndodhet pozicioni i përroit në lagjen “e Re”, i cili grumbullon në shtratin e tij ujërat e një sipërfaqeje të konsiderueshme duke përfshirë nga lagjja “Mustafa Matohiti”, fshati Rerës, fshati Banaj, fshati Dukas dhe një pjesë të lagjes së Re, krijon probleme në kalueshmërinë e rrugëve kryesore në këto zona. Me qëllim parandalimin e përmbytjeve të banesave që ndodhen në përgjatë shtratin të këtij përroi, kërkohet pjesërisht veshja me beton e kanalit dhe pjesërisht mbyllja e kanalit me tuba betoni, duke u dhënë zgjidhje problemit për rreth 60 familje.

Fondi me vlerë 4,955,981.29 (katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë njëzetë e nëntë) lekë do të investohet për realizimin e këtij projekti.

Fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për vitin 2024 për mbrojtjen civile në totalin e vet për Bashkinë Patos ka vlerën 5,216,822.41 (pesë milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzetë e dy pikë dyzetë e një) lekë. Me shkresën nr. 539/1 prot., datë 23/02/2024 drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes “Kthim përgjigje për ndarje fondi”, Bashkia Patos ka bërë ndarjen si më poshtë në lëndë:

- Kodi i produktit 91707 AG** “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese” është 4,955,981.29 (katër milion e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një pikë njëzetë e nëntë) lekë,
- Kodi i produktit 91707 AB** “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” është 260,841.12 (dyqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e dyzetë e një pikë dymbëdhjetë). Kërkojmë nga KB miratimin për përdorimin e këtij fondi.